



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Nr. 344 Prot.

Korçë, më 16.05.2022

**SHPALLJE KONKURSI PËR DREJTOR INSTITUCIONI ARSIMOR TEK SHKOLLJA
MB "DHIMITRAQ GJATA" RRËMBEC
MB LOZHAN I RI
MB "TAFIL REXHEPI" PIRG
MB "BARDHYL POJANI" POJAN
MB "NEFAIL ROZANI" PODGORIE
MB SHEQERAS ZVAP MALIQ**

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 "Për Miratimin e Rregullores për Funkionimin e Institucioneve Arsimore", Udhëzimit Nr 30 datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar" i ndryshuar, kreut I, gërma A dhe gërma B, të Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" i ndryshuar,

Shpallet konkursi tek Shkolla;

MB "DHIMITRAQ GJATA" RRËMBEC

MB LOZHAN I RI

MB "TAFIL REXHEPI" PIRG

MB "BARDHYL POJANI" POJAN

MB "NEFAIL ROZANI" PODGORIE

MB SHEQERAS

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucionit arsimor :

Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas rreçaktiveve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe vleresim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit.



Adresa: " Dhimitër Denasi"

Lgji. 18, AL 7001, Korçë

ëbsite: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>

Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor:

Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të shtojcës 1/Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020, i ndryshuar)

- Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së punës (e noterizuar)
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID).
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit).

· Certifikatën e drejtuesit të IAPP ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për ta kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.

· Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas shtojcës nr 2 bashkëlidhur udhëzimit)

· Vërtetim nga institucioni ku punon se aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.

· Deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të institucionit arsimor, ku po konkurron për pozicionin drejtues (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) (sipas shtojcës nr 3 bashkëlidhur udhëzimit).

Aplikanti për drejtues institucioni arsimor duhet të paraqesë në ZVAP Maliq dosjen personale me dokumentacionin e sipërshënuar me anë të shërbimit postar, nga data 16.03.2022 deri 25.03.2022

Pas shpalljes së procedurave dhe publikimit në faqen zyrtare nga DRAP Korçë, të njoftohet zyrtarisht ZVAP Maliq, për shpalljen e këtyre procedurave edhe në faqen zyrtare të ZVAP Maliq dhe ambjenteve publike të saj.

DREJTORI

KRISTAQ GRABOCKA



Adresa: " Dhimitër Denasi"

Lgji. 18, AL 7001, Korçë

ëbsite: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/>